REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Ballsh, më 27.07 **.2022**

Nr. 3812 **Prot.**

VENDIM

Nr. 42 **Datë** 26.07**.2022**

PËR

AKORDIMIN E TITULLIT "QYTETAR NDERI", I BASHKISË MALLAKASTËR LUTO REFAT SADIKAJ

Në zbatim të pikës m, neni 54 i ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të nenit 15 të ligjit nr. 112/2013, "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" , të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër nr. 12, datë 24.02.2020, "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër", si dhe të shkresës nr. 4 prot., datë 10.03.2022 "Propozim për dhënie tituj nderi", të Shoqatës "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit", administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 1350 prot., datë 10.03.2022, relacionit datë 19.07.2022 të Komsionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit, ngritur me Urdhërin të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër nr. 537, datë 11.12.2020,

VENDOSI:

1. Dhënien e titullit "Qytetar Nderi", Luto Refat Sadikaj, pas vdekjes, me motivacion: "Për kontributin e çmuar si pilot i talentuar mallakastriot i cili u shqua në elementët e përdorimit luftarak të aeroplaneve me të cilët ishte pajisur aviacioni luftarak shqiptar. Luto Refat Sadikaj futet në radhën e pilotëve "elitë" të aviacionit shqiptar të të gjitha kohëve. si pilot me teknikë pilotimi të lartë e të qëndrueshme që dha jetën në krye të detyrës".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Sportit, Turizmit dhe Shëndetësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi në bazë të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETAR

Fitim Baraj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALLAKASTËR

Adresa: Lagja 18 Prilli Ballsh Mallakastër Tel: +355 313 23493, posta elektronike: ballshi@bashkiamallakaster.gov.al, faqja zyrtare: ëëë.bashkiamallakaster.gov.al